“Atij muslimani që e godet ndonjë fatkeqësi dhe thotë atë që e ka urdhëruar Allahu: “Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi." (El Bekare, 156) O Allah, më shpërble në fatkeqësinë time dhe ma zëvendëso me diçka më të mirë!”

Nëna e besimtarëve, Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: “Atij muslimani që e godet ndonjë fatkeqësi dhe thotë atë që e ka urdhëruar Allahu: “Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi." (El Bekare, 156) O Allah, më shpërble në fatkeqësinë time dhe ma zëvendëso me diçka më të mirë!”, Allahu ia zëvendëson me diçka më të mirë.” Ajo shton: “Kur vdiq Ebu Seleme, thashë: “Cili musliman është më i mirë se Ebu Seleme, familja e parë që bëri hixhret tek i Dërguari i Allahut ?!” Megjithatë, unë e thashë atë lutje, kështu që Allahu ma zëvendësoi me të Dërguarin e Tij .”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Nëna e besimtarëve, Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!), tregoi se e kishte dëgjuar Profetin duke thënë: "Nuk ka asnjë musliman që goditet nga një fatkeqësi e pastaj thotë atë që Allahu e ka udhëzuar të thotë: “Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi." (El Bekare, 156) O Allah, më shpërble në fatkeqësinë time dhe ma jep shpërblimin për durimin, dhe ma zëvendëso me diçka më të mirë! Allahu ia zëvendëson me diçka më të mirë.” Ajo tha: "Kur vdiq Ebu Seleme, thashë: "Kush nga muslimanët mund të jetë më i mirë se Ebu Seleme, familja e parë që emigroi te i Dërguari i Allahut ? Pastaj e thashë këtë lutje me ndihmën e Allahut, dhe Allahu ma zëvendësoi atë me të Dërguarin e Allahut , i cili ishte më i mirë se Ebu Seleme."

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65772